

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008, ‘PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE’, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nisma propozuese e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, ‘Për miratimin e niveleve të tarifës doganore’, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon unifikim të tarifës doganore, në masën 10%, për të gjitha kodet tetëshifrore të kategorisë 8418 (njësi frigoriferike) të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me qëllim krijimin e një konkurrence të drejtë e të ndershme për të gjithë importuesit që operojnë në këtë veprimtari.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me anë të këtij projektligji propozohet unifikim i tarifës doganore, në masën 10%, për të gjitha kodet tetëshifrore të kategorisë 8418 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM).

Në 1 vit importohen rreth 91 mijë njësi frigoriferike, nga të cilat rreth 50 mijë janë frigoriferë, përkatësisht, me origjinë nga Kina (45%), Rumania (17%) dhe Polonia (11%). Në grupin e frigoriferëve përfshihen një gamë e gjerë produktesh, të tilla si frigoriferë shtëpiakë, banakë frigoriferik, frigoriferë që përdoren në industri të caktuara, ftohëse etj. Ky produkt klasifikohet në kodin 8418 të NKM-së, brenda të cilit përfshihen 20 kode tarifore dhe nga të cilët vetëm 4 prej tyre kanë tarifë doganore 2% dhe 16 kode të tjera kanë tarifë doganore 10%.

Sipas të dhënave, rreth 77% e frigoriferëve në Shqipëri zhdoganohen në kodet tarifore 8418 10 20, 8418 10 80 dhe 8418 30 20, me tarifë doganore 2%, dhe në pjesën e mbetur të kodeve aplikohet tarifë doganore 10%.

Kjo mënyrë e diferencuar taksimi ka sjellë klasifikim të gabuar të kodit tarifor nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, duke përfituar nga aplikimi i taksës prej 2% e jo 10%. Duke qenë se çdo vit kodet doganore të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave ndryshojnë për shkak të hyrjes në treg të mallrave të reja, që nuk janë të klasifikuar, si i tillë, procesi i korelimit të kodeve tarifore, sjell ndryshimin e kodeve e të tarifave të ndryshme. Gjithashtu, vërejmë një deklaram jo korrekt të vlerës reale të mallit, për arsye të pamundësisë së administratës doganore për të kryer verifikimet e faturave në vende të tilla si Kina apo Korea e Jugut, në mungesë të një marrëveshjeje të shkëmbimit të informacionit doganor me to.

Nga diferencimi i tarifave doganore në këto kode vihet re se çmimi mesatar për njësi frigoriferike është i ndryshëm, duke sjellë problematika të konkurrencës së ndershme.

(të dhënat në mijë lekë)

Frigorifer Kodi 8 shifror	Njësi	Taksë Doganore	TVSH	Tarifa doganore	Çmimi mesatar për njësi
8418 10 80/8418 30 20/ 8418 10 20	70,382	19,036	336,821	2%	26
Të gjithë kodet e tjera	20,880	19,475	297,465	10%	47

Përsa më sipër, klasifikimi i njëjtë i tarifës doganore të këtyre 4 kodeve do të sjellë krijimin e kushteve të njëjta për të gjithë importuesit që operojnë në këtë aktivitet dhe impakt pozitiv në buxhetin e shtetit në masën 50 milionë lekë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga dy nene.

Neni 1, i projektligjit, përcakton aneksin me kodet e mallrave, për të cilat tarifa doganore bëhet nga 2% në 10%.

Neni 2, i projektligjit, përcakton botimin në “ Fletoren zyrtare” dhe hyrjen në fuqi të ligjit në datën 1 janar 2019.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Drafti i projektligjit është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ky projektligj është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të cilat janë shprehur parimisht dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet në buxhetin e shtetit nga parashikimet e këtij projektligji vlerësohen pozitive, përafërsisht në masën +50 milionë lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE